

MINISTRIA E DILITËS SË PUBLIKATËS KOSOVËS  
/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO/  
GJYKATA THEMELORE NË MITROVICE /OSNOVNI SUD U MITROVICI / BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr. 272/2015

Përgjithësisht GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Gjyqtari Ragip Kadriu ne  
boshin që qështjen juridike te paditesve; dhe nga Mitrovica te  
cilet sipas autorizimit me shkrim i perfaqson Avokat nga Mitrovica kunder  
te paditures; Komuna e Mitrovices te cilën e perfaqson Avokati Publik Komunal  
, baza e kontestit; shfrytëzim palujtshmerie, pase mbajtjes se shqyrimit kryesor te  
dt.15.04.2016 jep kete;

A K T G J Y K I M

I-APRÖVOHET kerkëspadia e paditesve; dhe  
nga Mitrovica dhe VERTETOHET se paditesit ne baze te shitblerjes ne  
vitin 1960; si dhe mbajtjes me mirbesim mbi 20 vite, janë shfrytzues me nga  $\frac{1}{2}$  te pjeses  
se parceles katastrale nr. 2873-1 me kultur are e kl. 3, ne vendin e qujtor "Mbi kazerm",  
me sipërfaqe prej S= 743m<sup>2</sup>, me masa dhe kufi qe janë shenuar ne skicen e terenit te  
ekspertizes dhe ne terasi te parceles katastrale 2871-3, me kultur kulloze e kl.3 ne vendin  
e qujtor "Mbi kazerm", me sipërfaqe S=231m<sup>2</sup>, me masa dhe kufi qe janë shenuar ne  
skicen e terenit te ekspertizes e cila palujtshmeri evidentohet ne emer te P.SH

II- DETYROHET te paditura qe te iu njoh kete te drejte paditesve dhe te  
lejojë qe kete ta regjistrojne prane Drejtorese per Gjëodezi Kataster dhe Prone ne  
Mitrovice ne afatin prej 15 diteve, nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi.

Secila pale i bartë shpenzimet e veta te proedures kontestimore

A r s y e t i m

Paditesit ne padin e parashtruar si dhe ne seancat e mbajtura permes te  
autorizuarit te tyre kane theksuar se i ati i paditesit dhe njeherit gjysh i paditesit  
tani i ndjer, qysh ne vit 1960 ka bler palujtshmerin tani lendore nga shitci i cili ne  
kohen e shitjes ka pasur qellim te shperngulet ne Turqi. Kontrata e shitblerjes ka qene  
gojore dhe eshte permbushur ne terasi eshte bere pagesa e qmimit kontraktues dhe qe ne  
morrhenite blerjes se kesaj palujtshmerie i ati-gjyshi i padiesve sbashku me familjen e

vete ka hyr ne posedim te prones ku i njeiti ne vazhdimsi e ka shfrytzuar pa asnje lloj kufizimi apo pengese dhe ka ndertuar shtepine e banimit .

I autorizuari i paditesve ne seancen e shqyrtimit kryesore ne fjalen perfundimtare i propozoi gjykates qe padine dhe precizimin e kerkespadise ta aprovoi si te bazuar nga se paditesit te drejten e shfrytzimit nc kete palujtshmeri e kane fituar ne baze te shifberjes e cile eshte ber ne vit 1960 si dhe mbajtjes me mirbesim mbi 20 vite.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Perfaqsuesi i te paditures ne pergiqje te padise dhe precizimit te kerkespadis konsideron se kjo qeshtje juridike-perkatisht kontest duhet trajtuar duke pase ne konsiderat natyren e palujtshmerise, sipase rnatyres se rexhimit juridik te palujtshmerise dhe menyres se vendosjes sipase praktikes gjyqsore ne raste te ngajashme. Shtrirjen dhe pozicionin ne raport me situaten ndertimore dhe urbanistike, pazicionin dhe shtrirjen ne raport me kufizimet me palujtshmerit kufizuese te pronesive te tjera te gjetura sipas vertetimit te gjendjes faktike e qe duhet te rezultojne vendimin me epilog te rezultatit te provave.

Ne fjalen perfundimtare i prpozon gjykastes qe ne baze te rezultatit te provave te nxjerr vendimin perkates.

Shpenzimet e procedures nuk i kerkoi.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesore zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pase administrimit dhe-vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vndosur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi; Certifikatat e pronesise; Njesia kat. nr. P. , Njesia kat. P te dt.11.03.2015, Ekspertizen e ekspertit gjeodet dt.16.11.2015, beri veshtrimin ne skicen e terenit nga i njeiti ekspert dt.16.11.2015, Proqesverbalin e kesaje gjykate mi kqyrjen ne vend dt.13.11.2015, ndegjoi deshmitaret; si dhe ndegjoi paditesin dhe konstatoi kete gjendje faktike.

Nga Certifikatat e pronesise te cekura me larte konstatohet se parc. kat. tani lendore evidentohet ne emer te paditures.

Nga konstatimi dhe mendimi i eksperit gjeodet te cekur me larte konstatohet se ; pase matjeve te kryera te pjeseve kontestuese te palujtshmerise nga ana e ekspertit gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Katastrit ne Mitrovice, eshte vertetuar se palujtshmeria kontestuese bie -gjegjesithe e perbane parc. e cekura me larte me masa dhe kufij te shenura si ne ekspertizen e dhene me shkrime qhe skicen e terenit te cilat jane pjese perberse te kesaje gjykates.

Nga skica e terenit e sipercekur, shifet shtrija, perkufizimi dhe siperfaqja e palujtshmerise tani lendore.

Nga proqesverbali mbi kqyrje ne vend i kesaj gjykate i sipercekur vertetohet se; palujtshmeria lendore gjendet mu afer shtepis 2-katshe, te paditesve e cila lidhet me palujtshmerin tani lendore te cilen paditesit e shfrytzojne si oborr per nevoja familjare dhe se kjo plujtshmeri eshte e perkufizuar fizikisht dhe perreth ka shteti private .

Deshmitari deklaroi; se paditesit i ka fqinje dhe te njejt i njef para 30 viteve. Sipas njoburive qe ka kete palujtshmeri e kane blere nga nje person i cili eshte shperngul ne Turqi, qysh para 50 viteve dhe e din se te njejt ne ket vend kan shtepin familjare dhe se kete shteti se bashku me oborr e shfrytzon pa kurfar pengese nga askush.

Deshmitari deklaroi se paditesit i ka fqinje dhe sipas asaje qe ka ne dijeni te njejt kete palujtshmeri e ka bler nga nje person i cili qysh moti eshte shperngul ne Turqidhe dhe preje se mban mend e kan shfrytzue pa asnje penges nga kushdoqoft ne shfrytzimin e kesaj palujtshmerie.

Deshmitari dhe deklaruan, te njejt Jane fqinje te pare ne mexhe me tani paditesit, atu kane lindur dhe se te njejt, asnjehher nuk kane pasur ndonje mosmarrveshje apo ndonje pengese lidhur me palujtshemrim tani lendore dhe se paditesit e shfrytzojne ket palujtshmeri pa ndonje penges apo mosmarrveshje nga ne, fqinjet apo kushdoqoft.

Paditesi ne cili te pales deklaroi; palujtshmerin tani lendore ne vit 1960 e ka bler i ati i tije tani i ndjere para 3-viteve, nga shitesi i cili eshte shperngulur ne Turqi per shkaqe te njobura ne ate kohe e qe emri nuk i kujtohet per shkak te kalimit te kohes dhe se ka qene femije. E dine se kete palujtshmeri qe nga shitblerja e edhe tani e kane pasur ne shfrytzim dhe disponim te lire dhe te papengaur gjermetani dhe qdoher e kan ditur se kjo eshte pronesi e tyre . Ne kete vende dmth; mexhe kame te ndertuar shtepin 2-kateshe dhe se per nevojat e saje per perdonim te rregullt te shtepise e kane shfrytuar kete palujtshmeri me antar te familjes dhe se e njejt ka qene e perkufizuar edhe fizikisht qyshe nga shitblerja e edhe tani.

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me larte , gjykata erdhi ne perfundim dhe konstatoi se ne vit 1960, patundshmerin tani lendore i ati i paditesit te pare, njeherit gjysh i paditesit te dyte, ish nga Mitrovica tani i ndjere , sipas -marrveshjes gojore nga shitesi, pronari faktik i palujtshmeris tani lendore i shperngulur ne Turqi e ka bler ket palujtshmeri te cilen e ka shfrytuar me familje-paditesit gjer ne vdekjen e tije pa pengesa nga askush e paditesit edhe gjermetani.

Gjithashtu nuk ka ndonje prove nga e paditura apo ndokush tjeter se kunder paditesve eshte ugritur apo zhvillura ndomjre proceduer-kontest, lidhur me palujtshmerin tani lendore.

Ligji mbi Marrdhenjet Themelore Pronesoro Juridike [LMTHPJ], Gaz. Zyrt. RSFJ Nr. ne fuqi prej 1 Shtatori 1980 deri me 20 Gusht 2009, [nen. 296-297], te Ligjet Nr. Mbi Pronesin dhe te Drejtat tjera sendore, [ Gaz.Zyrt. e Republikes se Kosoves Nr. , ne Kosove ne fuqi nga 22 Marsi 1989, eshte ligj i aplikushem, baazuar ne nen 1.1[b], te Rregullores se UNMIK-ut Nr.

Ne baze te nen 20.1 te LMTHPJ , te sipercekur eshte percaktuar se e drejta e pronesise fitohet; sipas vet ligjit, punes juridike dhe trashigimi.

Sipas nen 21 te ligjit te sipercekur eshte percaktuar se e drejta e pronesise sipas vet ligjit nder tjera... fitohet edhe me mbajtje..

Ne baze te nen. 28 al. 4 te LMTHPJ te sipercekur eshte percaktuar ; se mbajtsi i ndershem i sendit te palujtshem ne te cilin tjetri ka te drejten e pronesise e fiton te drejten e pronesise ne ate send me mbajtje me kalimin e 20 viteve..

Ne baze te nen 40 te Ligjet per pronesin dhe te drejtat te tjera sendore, Ligji nr. O3/L-154, eshte percaktuar se; Personi i cili me mirbesim e ka njezet [20] vjet ne posedim te panderprer nje palujtshmeri ose nje pjese te saje e fiton pronesin ne te.

Ne baze te gjendje se vertetuar faktike ne rastin konkret nga momenti i shiftblerjes i ati i paditesit , njeherit gjysh i paditesit si dhe paditesit e kane pasur ne shfrytzim dhe disponim te lire kete palujtshmeri dhe ate me mirbesim dhe papengesa nga askush . Prandaj ne anen e paditesve egzistojn te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronesise ne baze te mbajtjes e keto jane; mbajtja me mirbesim, koha e nevojshme si dhe shfrytzimi i papengueshem i kesaje palujtshmerie.

Mbajtja me mirbesim ekziston se i ati-gjyshi i paditesve kete palujtsheri e ka blere nga shitesi -pronari faktik i saje .

Koha e nevojshme mbi 20 vite, ekzistet sepse i ati-gjyshi i paditesve kete palujtshmeri e ka bler ne vit. 1960.

Gjithashu nga momenti i shitblerjes-blersi i ati-gjushi i paditesve me familje te te tije ka hyre ne posedim dhe shfrytzim te lire dhe te papengushem te kesaje palujtshmerie te cilen paditesit e shfrytzojne edhe tan e tutje ne vazhdimesi.

Fase kesaje analize, perfundimi i gjykates eshte se paditesit kane arritur te afrohmojnë se te njeftit kane baze t'ajtë. Edhe ne kerkespadin e tyre nga se ne rastin e fit te kesaj palujtshmerie tan

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore , bazohet ne baze te nien.  
450 te LPK

Nga si u tha me larte u vendos si ne dispozitive te ketije aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE  
C.nr.272/2015 dt 15.04.2016.

G j y q t a r i,  
Ragip Kadriu,

KESHILLE JURIDIKE; Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankesa ne  
afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit, Gjykates se  
Apelit te Kosoves e permes kesaje gjykate.